



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 67/2019

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7874, DATË 17.11.1994, “PËR STATUSIN
E VETERANIT TË LUFTËS ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE
TË POPULLIT SHQIPTAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, bëhet shtesa e mëposhtme:

Neni 1

Në fund të nenit 7 shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Dita e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar është data 20 korrik.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 3.10.2019